

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.60 / 2022	Data: 29.04.2022	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d), nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; nenit 26, paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010 që në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2022 të merr këtë:

VENDIM

PËR RISHQYRTIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 01 NR.51/2021 LIDHUR ME DESTINIMIN PËR VARREZA TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Destinohet për varreza prona e paluajtshme e komunës, Njësia Kadastrale Kadastrale 257-0, Zona Kadastrale -Vrellë me sipërfaqen prej 1 hektar, 66 ari e 58 metra nga sipërfaqja e përgjithshme prej 102846 m².
2. Qëllimi i destinimit të pronës së paluajtshme e lartcekur është shfrytëzimi vetëm për varreza sipas kërkesës së banorëve të fshatit Vrellë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010.

Për shkak të mungesës së hapësirës së mjaftueshme për varreza, përfaqësuesi i banorëve të fshatit Vrellë, Idriz Blakaj ka parashtruar kërkesën 01-400-48498 sipas së cilës ka kërkuar që nga sipërfaqja përgjithshme prej 102846 m² e Njesisë Kadastrale 257-0, Zona Kadastrale -Vrellë të ndahet një pjesë e caktuar e kësaj prone për shfrytëzimin e saj për varreza të banorëve të fshatit Vrellë.

Me qëllim të realizimit të interesit publik propozohet destinimi për varreza të pronës së paluajtshme të komunës ashtu siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Propozim-Vendimi andaj kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e tij.

REPUBLICA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËR QËLLIMET E PËRZEMËRIT
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
 Uales-Izlazna
 00 Nr. 033-33
 Br:
 Data: 06.05.2022
 Datimi:
 ISTOG-ISTOK

Kryesuesi i Kuvendit
 z. Enver Rugova



